



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12, 17 dhe 18.1 shkronja (a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të datës 4 qershor 2008, nenit 4, 7 dhe 8 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010, nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 29.06.2020, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM
PËR SHPALLJEN E INTERESIT PUBLIK PËR SHPRONËSIM TË
PALUAJTSHMERIVE NË FUNKSION TË NDËRTIMIT TË RRUGËS UNAZORE NË
LIPJAN

I.Qëllimi i këtij Vendimi është fillimi i procesit të implementimit të rrugës unazore pjesa lindore e qytetit, që sipas mundësive ekonomike dhe duke shfrytëzuar kapacitetet ekzistuese të arrihet deri te përmirësimi i gjendjes së komunikacionit për periudhën e planifikuar dhe njëkohësisht të vendosen kriteret për zhvillimin e mëtejshëm.

Zbatimi i dokumenteve të planifikimit – infrastruktura rrugore në raport me gjendjen faktike që rezulton në harmonizim dhe riplanifikim të zonave që ndikohen nga implementimi i planeve për shfrytëzim sa me racional dhe në interes të përgjithshëm. Me këtë Vendim .

MIRATOHET propozimi për dislokimin e trasese së planifikuar në funksion të rrugës unazore dhe shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmerive të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat ndikohen nga projekti – riplanifikim i trasesë pjesa që nderlidhë rrugën ekzistuese “Bajram Gashi”, “Sadik Shala” dhe pjesa e segmentit rrugor “Halil Metaj” si fazë e parë implementuese .

II. Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që nga dita e miratimit të këtij Vendimi të ndalojë kryjen e transaksioneve-bartjeve, ndarjeve si dhe të vendosjes në hipotekë, përkitazi me pronat e paluajtshme të cilat janë objek i shpronësimit.

III. Obligohet Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të pezullojë procedurat që ndërlidhen me Lejet ndërtimore, Leje Legalizimit përkitazi me pronat dhe zonat që janë pjesë e këtij Vendimi, që të zhvillojë procedurat përkatëse lidhur me hartimin e dokumentacionit ndërtimor për projektin e rrugës sipas këtij Vendimi, që të harmonizoj kushtet e përcaktuara në këtë Vendim me dokumentet e Planifikimit hapësinor – Harta Zonale e Komunës.

IV. Vlera e kompensimit të pronës caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës konform Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativë Nr.02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

V. Obligohet Zyra e Kryetarit-Sektorit pronëso-ro-juridik pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të zhvilloj procedurat e shpronësimit në pajtim me dispozitat të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010.

VI. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Sektorit pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati i Shërbimeve Publike.

VII. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 464-26331

Lipjan, më 29. 06. 2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

